



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Nr. 5904 prot.

Durrës, më 29 / 05 /2020

VENDIM

Nr. 578, datë 29, 05, 2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TE DETYRUAR VENDOR

ZONA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE Durrës, BASHKIA Durrës

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 97/2019 „ Për miratimin e Aktit Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave „Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore“, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 887 datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore“, VKM Nr.686 Dt.22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit“, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.130, datë 13.02.2020 “ Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese“, pas dorëzimit të Dokumentit të Planit të Detyruar Vendor nga AKPT -të, hartuar nga Bashkimi i operatorëve “Casanova-Hernandez“ + “Geosat“ shpk, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe raportit teknik për këtë dokument.

VENDOSA

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën 3,Njësia administrative nr.5, Bashkia Durrës, miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.130, datë 13.02.2020 “ Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese“.
2. Plani i Detyruar Vendor përmban dokumentacionin si vijon
 - Harta e Infrastrukturës
 - Harta e Përdorimit të Tokës

- Harta e Projektimit Urban
 - Relacioni dhe Rregullore e Planit të Detyruar Vendor
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën 3 Durrës, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.
 4. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit si njësi zbatuese dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Zv/Kryetar

Emiriana Sako

